

FJALA E DEPUTETIT FLORENC SPAHO

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në fakt, fjalën time e kisha një diskurs tjetër, por s'mund të qëndroj pa thënë dy fjalë miqësisht për koleget deputete. Me gjithë respektin, ju lutem, mos shani shumë, mos bërtisni shumë, sepse në subkoshiençën e kolegëve deputetë burra, duket sikur i eklipsoni, sa detyrohen të shajnë e të bërtasin më shumë, duke menduar se kjo është diçka që tregon se janë burra. Po në tjetër vend duket burri, dhe burrin e dallon puna dhe e vërteta. Natyrisht, puna e qeverisë gjatë mandateve të kaluara është vlerësuar nga qytetarët, të cilët na kanë besuar edhe këtë mandat të tretë. Patjetër që ky besim i dhënë na e shton përgjegjësinë për ta justifikuar atë, por na shton edhe besimin se deri tani kemi qenë në rrugën e duhur, ndonëse dëshira ka qenë shumë herë më e madhe se sa mundësia. Patjetër që krahasimin e bëjmë me veten, sfidën për t'u përmirësuar e kemi me veten. Pavarësisht sfidave e vështirësive, kemi arritur të shohim progres në përbalimin e situatave të paparashikuara. Singërisht, nuk arrij të kuptoj, në fakt e kuptoj, por nuk dua ta besoj, se përse kolegët opozitarë jo vetëm që mohojnë gjithçka, por edhe vërsulen të komentojnë negativisht, pa argumente e pa arsye objektive. Natyrisht që kritikën dhe mendimet ndryshe janë normale dhe të dobishme kur vërtet janë të mbështetura në argumente, gjë që do të ishte ajo që do të prisnim nga një opozitë normale dhe e shëndetshme, me diskutimet konstruktive për të bërë më të mirën për të gjithë qytetarët që na kanë votuar. Por si mund të ketë diskutime konstruktive me një opozitë, që vetëm sulmon dhe zeron çdo punë të bërë në shërbim të qytetarëve.

Do të ishte më e pranueshme nëse diskursi do të ishte i fokusuar te gjërat që ju mendoni se nuk janë bërë e që duhen bërë, por pa mohuar ato që kemi arritur të bëjmë gjatë këtyre dy mandateve, sepse edhe ju vetë do të ishit më të besueshëm te qytetarët, për ata qytetarë që ju kanë votuar e të cilëve u detyroheni shumë. Megjithatë, me aq sa po dëgjoj këtu, një pjesë juaja, në fakt, nuk e kanë problem se si duken te qytetarët. Më shumë duan të duken para kryetarëve të tyre se kush bërtet apo shan më shumë. A mund të mbulohen e të fshihen të gjitha punët, arritjet, sukseset, kur ato janë aq të dukshme, sa dhe të prekshme? Gjithsesi, puna juaj. Ndoshta ju keni sy, por nuk doni të shikoni; keni veshë, por nuk doni të dëgjoni. Në fakt, është një diagnozë me simptoma të tilla, që nuk ka mjek që e merr përsipër. Patjetër, unë dhe kolegët e mi, siç kemi falënderuar anëtarët e kabinetit qeveritar për punët e bëra mirë, kemi adresuar edhe problematika të ardhura nga qytetarët dhe kemi pranuar që mund të ketë edhe gjëra që meritojnë të kenë një fokus akoma më të madh, apo të bëhen më mirë nga ç'janë bërë. Pse jo? Sepse siç e thashë më lart, sfidën dhe krahasimin ne i kemi me veten. Jo më pak se para dy javëve, këtu në seancë, në parlament, por edhe në komision unë kam ngritur një problematikë, që i shqetëson të gjithë qytetarët e çdo familje shqiptare, por kësaj do t'i rikthehem në fund të fjalës sime, sepse do një fokus të veçantë nga të tria ministrinë.

Vetëm falë një pune dhe ekspertize shumëvjeçare buxheti ka ardhur gjithnjë e në rritje, nga viti në vit, dhe sot ne kemi buxhetin më të madh në tridhjetë vjet, ndonëse jemi pas dy gjendjeve të njëpasnjëshme, aspak të zakonshme. Do të kishim dashur të arrinim shumë më shumë, por midis dëshirës dhe mundësisë ka një ndryshim të madh. Brenda mundësive dhe me dëshirën maksimale, kemi arritur të përballojmë me sukses situatën e tërmetit, rindërtimin e shtëpive të shkatërruara nga tërmeti, pandeminë dhe fushatën e vaksinimit. Pa diskutim, kemi ende shumë gjëra të nisura, të cilat presin t'i çojmë përpara, që të finalizohen. Ndër sfidat më të mëdha ka qenë pa diskutim përballja me COVID-19 dhe efektet që kjo pandemi solli në aspektin shëndetësor, në ekonomi, në arsim, në bujqësi apo në energjetikë. Kjo ka qenë arsyeja pse kemi investuar më tepër në shumë fusha dhe kemi ndikuar në rritjen ekonomike.

Të dashur qytetarë,

Projektbuxheti për vitin 2022 do të vazhdojë të mbështesë sektorët prioritarë, si në shëndetësi, në arsim, në rindërtim, në infrastrukturë, në bujqësi, në kulturë, në mbrojtje e të tjera. Rritja ekonomike e 2022-shit parashikohet të ketë një trend uljeje për sa i përket papunësisë në krahasim me vitin 2021. I kemi kushtuar rëndësi të veçantë kujdesit social dhe atij shëndetësor. Kemi adresuar pabarazitë sociale të shkaktuara nga pandemia. Me mjaft rëndësi është ndërtimi i sistemit të të dhënave në aksesin dhe shpërndarjen në shëndetësi të popullatës, e po ashtu nxitja e inovacionit dhe rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit në mjekësi. Në fakt, për sa i përket shëndetësisë, nuk mund të lë dot pa përmendur edhe disa investime që janë bërë në qytetin e Elbasanit, si në qendrat shëndetësore atje ku nuk ka pasur, por edhe atje ku ka pasur, ku për më shumë se dyzet vjet nuk është vënë dorë, e po ashtu, për ndërtimin e Urgjencës dhe Patologjisë në qytetin e Elbasanit, ku marrin shërbimin shumë qytetarë të Elbasanit dhe ku punojnë në kushte bashkëkohore shumë kolegë, mjekë, infermierë, të cilët rrisin edhe cilësinë e shërbimit. Patjetër, shumë shpejt presim të inaugurojmë rikonstrukcionin total që i është bërë dhe po i bëhet Spitalit Pediatric të Elbasanit. Buxheti i shëndetësisë për 2022-shin mbështetet në shtyllat e programit të qeverisë për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, duke synuar mbulim shëndetësor universal, shërbime cilësore, mbrojtjen e shëndetit publik përmes vaksinimit antiCovid të popullatës, konsolidimin dhe rritjen e mburojës sociale për kategoritë në nevojë, mbulimit 100 % falas të paketave mjekësore të dializës, transplantit të veshkave, kardiologjisë, kardiokirurgjisë, radioterapisë dhe kataraktës.

Buxheti i vitit 2022 garanton modernizimin e infrastrukturës së shërbimit shëndetësor në të gjitha nivelet, duke nisur nga qendrat e kujdesit parësor e deri te spitalet universitare, me synim rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor për qytetarët. Nuk mund të lë pa përmendur edhe shtresën e të moshurave e të njerëzve në nevojë apo njerëzit me aftësi të kufizuara, të cilët janë parë me prioritet maksimal, dyfishimin e ndihmës ekonomike për familjet me më shumë se tre fëmijë nën moshën 18 vjeç, trefishimin e ndihmës ekonomike për fëmijët me statusin e jetimit, si dhe për gratë e trafikuarra e të dhunuara. Grupet vulnerabël do të mbështeten edhe përmes punësimit në ndërmarrjet sociale. Gjatë mandatit të kaluar kemi investuar fort në arsim, duke ngritur edhe ekipet multidisiplinare pranë institucioneve arsimore, duke shtuar në radhët e profesionistëve edhe mësuesit e arsimit special, të cilët tashmë i kemi shumëfishuar dhe në numër, nisur nga nevojat për një shërbim të tillë. Tashmë jo vetëm që është rritur numri i mësuesve specialë, por edhe i punonjësve të shërbimit social dhe i psikologëve në shkolla, si dhe është bërë vendosja e oficerëve të sigurisë. Prezenca e këtyre profesionistëve bën të mundur mbarëvajtjen dhe shmangien e shumë problematikave, që lindin apo mbarten që nga familjet e tyre. Siguria e fëmijëve tanë si në aspektin fizik, ashtu edhe në atë psiko-emocional është primare, ndaj edhe nismat e investimet në këtë drejtim do të vazhdojnë edhe gjatë këtij mandati të ri jo vetëm në investimet në infrastrukturë, si në mjediset shkollore, në ato sportive apo rrikreative, por edhe për shërbime sa më cilësore për mbrojtjen dhe sigurinë. Buxheti për arsimin

dhe sportin vazhdon të ketë trend rritës si në vlerë nominale, ashtu edhe në përqindje, me 15 për qind më shumë në krahasim me vitin 2021. Me fondet e planifikuara për arsimin në vitin 2022 do të sigurohet mbështetja e arsimit bazë, të mesëm dhe të lartë, duke i orientuar kurrikulat sipas nevojave të tregut të punës.

Prioritet për vitin 2022 do të jetë rritja e numrit të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor; sigurimi i shërbimit të transportit për nxënësit dhe mësuesit; ofrimi i teksteve shkollore falas për nxënësit që ndjekin arsimin bazë, si dhe tekste shkollore falas për nxënësit nga shtresat sociale në nevojë për arsimin e mesëm dhe të lartë; ofrimi i bursave financiare apo kuotave ushqimore për nxënësit me nevoja të veçanta; reduktimi i numrit të klasave kolektive; përmirësimi i infrastrukturës shkollore, si dhe shkolla dhe konvikte të reja, sipas standardeve. Më vjen mirë dhe për këtë dua të përgëzoj Ministrinë e Mbrojtjes, e cila pas shumë vitesh bën të mundur rritjen prej 30% të pagave për Forcat e Armatosura, një vëmendje, e cila ka munguar realisht prej vitesh apo rritja e pagës me 150% për punonjësit e rendit, të cilët punojnë larg vendit ku jetojnë.

Të nderuar kolegë, Dua të ndalem pak te Ministria për Rininë dhe Fëmijët, duke vlerësuar ministren në detyrë, e cila edhe pse e re në këtë detyrë, prej pak kohësh ka bërë një punë të madhe, duke organizuar një maratonë takimesh me të rinjtë për t'i vënë si prioritete në buxhetin e vitit 2022 problematikat që të rinjtë kanë adresuar. Ky program do të jetë i bazuar tek artet, zejet, inovacioni dhe aktivitetet sportive. Sa i përket problematikës që doja të adresoja, jo pa qëllim e përmenda Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e të Rinjve, sepse, siç jua kam thënë edhe para 2 javësh, duhet një vëmendje e shtuar për fëmijët, sidomos për grupmoshën 10-15 vjeç sa u takon deformimeve të kolonës. Kjo është edhe arsyeja që kur ka problematika, ne patjetër duhet t'i adresojmë, sepse punët që janë bërë mirë nuk mund të mohohen. Faleminderit!